



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 262 prot

Tiranë, më 16 04 2024.

VENDIM

Nr. 2 datë 16.04 2024

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 8/4/2024

Këshilli Konsultativ bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.910, datë 21.12.2016, “Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 8.4.2024 vendosi:

1. Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakort dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

a) Pas pikës 11 të nenit 3, shtohen pikat 11/1 dhe 11/2, me këtë përmbajtje:

11/1 “Leje ndërtimi për investime dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike” është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve me qëllim investimet dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike;

11/2. “Këshilli Teknik Publik Vendor”, është organi kolegjal i ngritur nga autoritetet vendore, i përbërë nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë, i miratuar nga Këshilli Bashkiak, i cili shqyrton dhe vendos mbi miratimin apo refuzimin e kërkesave për lejet e ndërtimit dhe çertifikatat e përdorimit për investime dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike në kompetencën e autoritetit vendor, me përjashtim të lejeve të cilat janë kompetencë e Këshillit Kombëtar të Territorit

Të rishikohet neni 32 “Zhvillimi i detyrueshëm i tokës për shkak të pazbatueshmërisë së tij pasi konsiderohej se nuk plotësonte standartet e kufizimit të së drejtës së pronës sipas Kushtetutës si dhe parimit të qartësisë së normës;

b) Pas nenit 39, shtohet neni 39/1 me përmbajtje si më poshtë:

39/1. Leja e ndërtimit për investime dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike;

1. Leja e ndërtimit për investime dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim, mirëmbajtje, rehabilitim, apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, të cilat kryhen në infrastrukturën publike;

2. Dokumenti i lejes për investime dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të kërkesës dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

3. Me përjashtim të lejeve të cilat janë kompetencë e Këshillit Kombëtar të Territorit, investimet dhe/ose mirëmbajtjet e infrastrukturës publike në kompetencë të autoriteteve vendore, shqyrtohen dhe miratohen apo refuzohen nga Këshilli Teknik Publik Vendor, sipas procedurës dhe dokumentacionit të parashikuar në rregulloren e zhvillimit të territorit;

4. Pavarësisht parashikimeve të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, lejet e ndërtimit për investime dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike përjashtohen nga zbatimi i kushteve dhe kufizimeve përsa i përket elementëve teknik të parashikuar për kushtet urbane, distancat, intensitetin, koeficientin e shfrytëzimit, etj. të parashikuara në dokumentat e planifikimit, si dhe procedurës për leje zhvillimi, por pa cënuar interesin publik apo privat;

5. Kërkesat dhe shqyrtimi apo ndërveprimi institucional për leje ndërtimi për investime dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike kryhen në formë shkresore, sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e zhvillimit të territorit duke u përjashtuar nga sistemi elektronik i lejeve;

c) Pas pikës 9 të nenit 42, shtohen pikat 10, 11 dhe 12, me përmbajtje si më poshtë:

10. Çertifikata e përdorimit për lejet e ndërtimit për investime dhe/ose mirëmbajtje të infrastrukturës publike miratohen nga autoriteti i cili ka miratuar lejen e ndërtimit, vetëm nëse punimet janë kryer në përputhje me lejen e miratuar të ndërtimit e vërtetuar kjo nga deklarata noteriale e zbatuesit të punimeve, mbikëqyrësit, kolaudatorit si dhe pas aktit të konfirmimit të kontrollit përfundimtar. Procedura dhe dokumentacioni për kontrollin

përfundimtar dhe pajisjen me çertifikatë përdorimi të objekteve në fjalë parashikohet në rregulloren e zhvillimit të territorit;

11. Për objektet e ndërtuara përpara hyrjes në fuqi të pikës 10 të nenit 42, nëpërmjet këtij ligji, të cilat janë ndërtuar nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Teknikë, si organe kolegjiale të ngritura më herët me vendim të Këshillit Bashkiak, pavarësisht sa është parashikuar në dispozitat ligjore të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore të tij, në dispozitat ligjore të Ligjit 8402/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), apo çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor, çertifikata e përdorimit do të jepet nga Këshilli Teknik Publik Vendor nëpërmjet procedurës dhe dokumentacionit që do të përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave;

12. Çertifikatat e përdorimit të miratuara sipas parashikimeve të pikave 10 dhe 11 të këtij neni, dërgohen për regjistrim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës shkresërisht nga drejtoria përkatëse që administron dokumentacionin e Këshillit Teknik Publik Vendor.

2. Për projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

a) Pas nenit 10, shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Sekretariati Teknik i KKTU kryen monitorimin e procesit të punimeve të ndërtimit kryesisht, apo në rast se vihet në dijeni nga qytetarët, nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj, ose nga inspektoriatet sipas legjislacionit për inspektimet, për shkelje të lejeve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, duhet të formulohet: “Sekretariati ka të drejtë të bëjë monitorimin si pjesë e përgjegjësisë dhe punës së tij dhe kur vihet në dijeni nga apo burime të tjera si media... pasi të ketë vlerësuar situatën rast pas rasti, në varësi të kompleksitetit që mund të paraqesë projekti i miratuar nga KKTU“;

b) Në nenin 13 të bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i katërt duhet të saktësohet se kush e bën kerkesën sepse ka mbivendosje të organeve mes Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore dhe Sekretariatit teknik të KKTU.

3. Për projektligjin **“Për përcaktimin e sasisë në përqindje të sipërfaqes së stokut të ndërtesave publike për t’u rinovuar çdo vit, kundrejt sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.

4. Për projektvendimin **“Për disa ndryshime në vendimin nr.283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e**

produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar, propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- a) Pika 10, të shtohet një pikë për përcaktimin e lartësisë së katit.
5. Për projektvendimin **“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për marrjen e masave parandaluese për përhapjen e zjarreve në toka bujqësore”**, propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
6. Për urdhërin **“Për ngritjen e task forcës ndërinstitucionale të sezonit turistik veror”**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- a) Të rishikohet taksa e fjetjes në hotele dhe njësitë akomoduese;
- b) Të rishikohet në urdhër përfshirja përveç zonave bregdetare në zbatimin e tij edhe kontrolli i fshatrave, pastrimi, kanalizimet, kolektorët të cilat shpesh lihen pa u prekur.

Z. Arbjan MAZNIKU
Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor
Bashkëkryetar

Z. Aldrin DALIPI
Kryetar i Shoqatës së Këshillit
të Qarqeve të Shqipërisë
Bashkëkryetar